



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr.354/4 prot.

Tiranë, më 14.04.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 32, datë 14.04.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA NGA ORGANET E
NGARKUARA NGA LIGJI GJATË PROCEDURËS SË NDJEKUR PËR
VLERËSIMIN E REZULTATEVE NË PUNË, NË INSTITUCIONIN E AGJENCISË
PËR ZHVILLIMIN BUJQËSOR DHE RURAL DHE PARALAJMËRIMIN E
INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR LIGJSHMËRINË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera nga organet e ngarkuara nga ligji gjatë procedurës së ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë, për nëpunësen Anxhela Meta, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, pranë institucionit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën me nr. 354 prot., datë 23.02.2026, nëpërmjet të cilit nëpunësja Anxhela Meta, me detyrë “Drejtor”, në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, pranë institucionit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, ngre pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e

legjislacionit të shërbimit civil gjatë procedurës së ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë, për periudhën 01.07.2025-19.10.2025, për këtë nëpunëse.

Në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësja parashtron se, në vlerësimin për periudhën në fjalë, është vlerësuar në nivelin 4 “*Jo kënaqshëm*”, në kundërshtim me parashikimet e nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, të ndryshuar.

Konkretisht, nëpunësja pretendon se, vlerësimi është kryer në kushtet konfliktit të interesit, pasi në rolin e Zyrtarit raportues/kundërfirmues/autorizues është vendosur eprori i saj i drejtpërdrejtë, Drejtor i Përgjithshëm, i cili gjatë kësaj periudhë vlerësimi ka nisur një procedurë disiplinore në ngarkim të saj.

Në këto kushte, është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të krijuara nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja Anxhela Meta, filloi procesin e verifikimit të informacionit, nëpërmjet shkresës nr. 354/1 prot., datë 03.03.2026, “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar pranë Komisionerit me shkresën nr. 354 prot., datë 23.02.2026, të dërguar nga nëpunësja Anxhela Meta*”, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të kësaj procedure vlerësimi, duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, me shkresën nr. 1507/1 prot., datë 06.03.2026, me objekt: “*Kthim përgjigje shkresës nr.354/1 prot., datë 03.03.2026*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 354/2 prot., datë 06.03.2026, ka dërguar dokumentacionin në të cilin materializohen aktet që pasqyrojnë veprimet administrative që janë kryer gjatë vlerësimit individual të punës për punonjësen në fjalë, për periudhën 01.07.2025 – 19.10.2025.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, rezulton se, me aktin nr. 1662 prot., datë 09.03.2022, të Departamentit të Administratës Publike, nëpunësja Anxhela Meta është emëruar “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, pranë institucionit të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, kategoria III-a.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit në këtë pozicion, nga eprori direkt, i cili mban njëkohësisht rolin e Zyrtarit raportues/kundërfimues/autorizues, është kryer procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën 01.07.2025 – 19.10.2025 (*periudha e vlerësimit nuk është e plotë, pasi nëpunësja ka qënë e pezulluar për shkak të ecurisë disiplinore të nisur në ngarkim të saj*).

Sa i takon procedurës së ndjekur gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, sqarojmë se, në bazë të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, që ka dalë në zbatim të kësaj dispozite, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik dhe duhet të respektohen të gjitha fazat e tij, ashtu si parashikohen në pikën 12, kreu II, i aktit nënligjor në fjalë, e konkretisht:

- Planifikimi, është momenti kur Zyrtari raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë Zyrtari raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karriere, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, në formularin e vlerësimit të punës, për periudhën 01.07.2025 – 19.10.2025, janë përcaktuar objektivat/aktivitetet; afati kohor për realizimin e tyre; njësia organizative ku raportohet; si edhe drejtoria/personi përgjegjës për kryerjen e veprimeve për realizimin e objektivave të planifikuar, por nuk janë të materializuara në një akt më vete.

- Bisedimet e ndërmjetme, zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku Zyrtari raportues takohet me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e kryer në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të evidentuar përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.

Në rastin në fjalë, rezulton se gjatë të gjithë periudhës së vlerësimit, midis Zyrtarit raportues dhe nëpunëses së vlerësuar ka patur komunikim të vazhdueshëm në lidhje me realizimin e detyrave. Për dokumentimin e këtij fakti, institucioni ka paraqitur disa e-maile të shkëmbyera ndërmjet këtij zyrtari dhe nëpunëses, si dhe praktikën shkresore, ku janë evidentuar shënime të përkatëse nga eprori i drejtpërdrejtë i nëpunëses, në lidhje me cilësinë e punës së kryer prej saj.

- Vlerësimi përfundimtar, është një proces që ka të bëjë me vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, duke respektuar afatet e vlerësimit.

Duke marrë në analizë mënyrën se si janë plotësuar ndarjet e formularit, (ndarjet A, B, C, Ç, D e DH), nga zyrtarët që ligji i ka ngarkuar me kompetencën e vlerësimit periodik, konstatohet sa më poshtë:

Ndarja A: Të dhënat personale

Në këtë ndarje janë plotësuar të gjitha të dhënat personale të nëpunësit: emri/mbiemri, pozicioni, institucioni, njësia organizative, drejtoria, vendndodhja, data e emërimit në pozicionin aktual, periudha e vlerësimit: 01.07.2025 – 19.10.2025, është përcaktuar Zyrtari raportues, si dhe është shënuar qëllimi i kryerjes së këtij veprimi administrativ, që është vlerësimi 6 mujor i rezultateve në punë, por nuk rezulton të jetë e plotësuar data e vlerësimit.

Ndarja B: Konteksti i punës

Në këtë ndarje janë shënuar objektivat e institucionit dhe objektivat e Programit të Njësive Organizative sipas përcaktimeve në planin e punës së institucionit të miratuar nga titullari, për periudhën 01.07.2025 – 31.12.2025.

Ndarja C: Objektivat dhe matësit e performancës

Rezulton se në këtë ndarje janë shënuar objektivat dhe matësit e performancës për periudhën 01.07.2025-19.10.2025, nga zyrtari i ngarkuar me këtë detyrë.

Kjo ndarje, ka 5 rubrika vlerësimi dhe konstatohet se në të gjitha rubrikat nëpunësi është vlerësuar nga zyrtari raportues me nivelin 4 “*Jo Kënaqshëm*” duke evidentuar komentet përkatëse në secilën rubrikë.

Ndarja Ç: Sjellja profesionale

Në këtë ndarje, e cila ka 6 rubrika vlerësimi, në 4 rubrika nëpunësi është vlerësuar nga zyrtari raportues në nivelin 4 “*Jo Kënaqshëm*” dhe në 2 rubrika është vlerësuar me nivelin 3 “*Kënaqshëm*”, duke argumentuar në rubrikën komente arsyet e këtij vlerësimi.

Më tej, në cilësinë e organit që ka përcaktuar objektivat e punës, matësit e performancës dhe sjelljen e vlerësueshme profesionale (në faqen 5 të formularit), Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka nënshkruar formularin.

Në rastin në fjalë, referuar strukturës dhe organikës në fuqi të institucionit, të tre zyrtarët vlerësues: Zyrtari raportues/kundërfirmues dhe autorizues, përfaqësohen nga i njëjti zyrtar, Drejtori i Përgjithshëm, i cili mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësen e vlerësuar, në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr.109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar.

Si rrjedhë, sa i takon pretendimit të nëpunëses për kryerjen e procesit të vlerësimit në kushtet e konfliktit të interesave, vlerësoj se ky pretendim **nuk qëndron**, pasi aktet nënligjore në fuqi përcaktojnë në mënyrë shteruese, caktimin e zyrtarëve vlerësues në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë. Në rastin konkret, pjesëmarrja e eprorit të drejtpërdrejtë të nëpunëses, si anëtar i Komisionit Disiplinor, nuk e vendos atë në kushtet e konfliktit të interesave, pasi vlerësimi i punës për nëpunësin civil dhe pjesëmarrja në Komisionin Disiplinor, janë dy procese të ndryshme që nuk kanë lidhje midis tyre dhe eprori i zhvillon ato për shkak të ligjit. Në rastin konkret nuk konstatohet ndonjë rrethanë tjetër që të provojë konfliktin e interesit.

Në ndarjen vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë, nëpunësja është vlerësuar në nivelin **4** (*Jo kënaqshëm*).

Ndarja D: Nënshkrimi

Konstatohet se kjo ndarje është plotësuar dhe nënshkruar nga Zyrtari raportues/kundërfirmues/autorizues, por nuk është plotësuar data në të cilën është bërë vlerësimi. Për këtë arsye, nuk evidentohet respektimi i afatit të përcaktuar në shkronjën c), pika 12, kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, sipas të cilit faza përfundimtare e vlerësimit të rezultateve në punë realizohet në periudhën 1–15 janar.

Gjithashtu, sa i takon njoftimit dhe vënies në dispozicion të formularit të vlerësimit për nëpunësen *A. Meta*, nga dokumentacioni i administruar konstatohet se ky akt i është dorëzuar në datën 18.02.2026, përmes shkresës nr. 1025/3 prot., datë 18.02.2026, “*Shkresë përcjellëse*”, të titullarit të institucionit, në tejkalim të afatit të përcaktuar më lart.

Më tej, nëpunësja, pasi është njohur me rezultatin e vlerësimit, ka nënshkruar formularin në datën 18.02.2016, duke parashtruar se nuk është dakord me vlerësimin dhe kërkon rivlerësim nga ana e zyrtarit autorizues.

Në vijim, rezulton se nga ana e Zyrtarit autorizues **nuk është kryer** procesi i rivlerësimit të rezultateve në punë, pasi nuk është plotësuar ndarja “DH”, e formularit “*Rivlerësimi nga zyrtari autorizues*”, pas kërkesës së nëpunëses për rivlerësim, në kundërshtim me kërkesat e pikës 9, kreu IV, të VKM-së nr.109, datë 26.02.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar. Mosrealizimi i fazës së rivlerësimit nga ana e Zyrtarit autorizues sjell cënimin e të drejtës së nëpunëses për një rishqyrtim objektiv dhe të paanshëm të procesit të vlerësimit, si dhe të ushtrimit efektiv të mjetit administrativ të ankimit.

Referuar problematikës së evidentuar më sipër, sa i takon afateve të kryerjes së procesit të vlerësimit të nëpunëses, vlerësoj se, zyrtarët vlerësues të përfshirë në këtë proces, duhet të tregojnë kujdes për respektimin e kërkesave të parashikuara në germën c), pika 12, kreu II, i VKM-së nr. 109, datë 26.2.2024, e ndryshuar, ku përcaktohet se: vlerësimi përfundimtar për secilën periudhë vlerësimi realizohet përkatësisht në periudhën 1–15 korrik dhe 1–15 janar.

Vonesat në këto afate, sjellin përgjegjësi disiplinore për zyrtarin vlerësues. Megjithatë, realizimi i këtij procesi jashtë afateve të parashikuara, nuk ndikon në ligjshmërinë e procesit, në ato raste kur, nuk sjell ndonjë pasojë në rezultatin e procesit apo në respektimin e të drejtave të nëpunësit të vlerësuar.

Në këto rrethana, sjellim në vëmendje të zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, se ky sistem vlerësimi është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 109, i Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Zyrtari autorizues të realizojë procesin e rivlerësimit të rezultateve në punë për nëpunësen Anxhela Meta, duke respektuar plotësisht procedurat e parashikuara në VKM-në nr. 109, datë 26.02.2014, i ndryshuar.
2. Ndarja “DH” e formularit, “Rivlerësimi nga zyrtari autorizues” të plotësohet dhe nënshkruhet, duke argumentuar në mënyrë të qartë arsyet e qëndrimit për rivlerësimin.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **15 ditë**, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësja Anxhela Meta.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)